

VENDIM
Nr. 46, datë 11.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 384, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “ENERGY TO ENERGY” SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 5.2.2021, të për gatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy to Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/12 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, me urdhrin nr. 125, datë 4.11.2020, të Kryetarit të ERE-s, ka filluar procedurat hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkuar që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin sipërcituar.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Energy to Energy” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 234, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/12-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Në pikën 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike” parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 5, germa “ç”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

“ERE heq një licencë kur i licencuari:

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit për energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.”.

- Në nenin 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

“Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën, subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.”.

- Me heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 9.3.2017, shoqëria “Energy to Energy” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Energy to Energy” sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti